



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 172, datë 29.09.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “KRESTON ALBANIA” SH.P.K.,  
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË  
“BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE” SH.A., PËR VITIN FINANCIAR QË  
MBYLLET MË 31.12.2023.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe të rregullores nr. 92, datë 31.05.2023 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërisë komisionere dhe institucioneve të tregut”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e shoqërisë “Kreston Albania” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**